



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SKRAPAR  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 129 Datë 14.12.2018

PËR  
HEQJEN E SIPËRFAQJES PREJ 23.947 HA PËR OBJEKTIN “MËLOVË” QË DO  
TË PËRDORËT NGA SHOQËRIA “VËLLEZRIT HAZISLLARI” SH.P.K PËR  
SHFRYTËZIMIN E MINERALIT GËLQEROR TË MERMERIZUAR.

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54/e, ligjin nr.9385 datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” të ndryshuar, VKM nr.438 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave /Bashkive“, VKM nr.591 datë 09.10.2018 për disa ndryshime në vendimin nr.1353 datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqjes e të vëllimit të fondit pyjor” të ndryshuar, VKM nr. 592 datë 09.10.2018 për disa ndryshime në vendimin nr.1374 datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” të ndryshuar dhe në shkresën e MTM Nr.9584, date 03.12.2018 “Për dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor” Këshilli Bashkisë pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Ndërmarrja e Shërbimit Ppyjor

VENDOSI:

Të miratojë kërkesën për vazhdimin e procedurave për heqjen e sipërfaqjes prej 23.947 ha për objektin “Mëlovë” që do të përdoret nga shoqëria “Vëllezrit Haziçllari” sh.p.k për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror të mermerizuar.

Vendimi u miratua me 14 vota pro , vota kundër s’ka, vota abstenim s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARI KËSHILLIT  
PARTIZAN GORÇE